



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË KURBIN**

**K Ë R K E S Ë**

**PËR CAKTIMIN E MASËS SË SIGURIMIT PASUROR TË SEKUESTROS  
PREVENTIVE**

**Drejtuar:**

**GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË**

**KURBIN**

Në Lac, sot me datën 9.7.2019.

Une Bardhyl Shehu, Prokuror në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin, pasi u njoha me aktet e çështjes penale nr. 152 të vitit 2019:

**KONSTATOVA**

Me datën 3.4.2019, Prokuroria Kurbin, mbi bazën e materialit kallzues të ardhur nga Drejtoria Vendore e Policisë Lezhe ka rregjistruar procedimin penal nr.152 për veprën penale të pastrimit të produkteve të vepres penale apo veprimtarisë kriminale, paraashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

**Nga hetimet e kryera deri tani ka rezultuar se :**

Me shkresën Nr. 6410 datë 12.04.2019, Drejtoria për Krimet Ekonomike e Financiare në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit ka dërgur informacionin bazuar në komunikatën operative të datës 05.04.2019, ku rezulton se, më datë 04.04.2019 nga ana e Komisarariatit të Kufirit dhe Migracionit Rinas, është bërë ekstradimi i shtetasit Ilir Lufaj, i biri i Pal, dhe Mare, i datelindjes 23.03.1976, lindur dhe banues në Fushe Mamurras, Kurbin, me kombesi dhe shtetasi shqiptare, sepse Gjykata e Venecias, Itali ka lëshuar urdhërin e “Arrestit Ndërkombëtar” për këtë shtetas për kryerje të veprave penale “Organizatë kriminale me qëllim emigracionin e paligjshëm dhe falsifikimin e

dokumenteve” parashikuar nga Kodi Penal italian, respektivisht vepër kjo e parashikuar nga neni 333 i Kodi Penal shqiptar.

Ne sistemin MEMEX jane administruar dhe keto informacione policore:

- ✓ Gjykata e Venecias, Itali ka lëshuar urdhërin e “Arrestit Ndërkombëtar” për këtë shtetas për kryerje të veprave penale “Organizatë kriminale me qëllim emigracionin e paligjshëm dhe falsifikimin e dokumenteve” parashikuar nga Kodi Penal italian, respektivisht vepër kjo e parashikuar nga neni 333 i Kodi Penal shqiptar.
- ✓ Me date 04.04.2019 shtetasi Ilir Lufaj eshte ekstraduar ne Itali .
- ✓ Shtetasi Gjon Pal Lufaj i vellai i Ilir Lufaj eshte shpallur ne kerkim me kartelet te "Kuqe" pasi autoritetet gjyqësore italiane, kanë lëshuar urdhër-arresti me nr.11645/13RGNR-9565RG GIP dt më 01.08.2016 për kryerjen e V. Penale:“ » Pjesëmarrje në grup kriminal për organizimin e emigracionit të paligjshëm duke falsifikuar dokumentat e udhëtimit »” të parashikuara nga Kodi Penal Italian.
- ✓ Shtetasja Migena Lufaj kunata e Ilir Lufaj eshte shpallur ne kerkim me kartelet te "Kuqe", pasi Zyra Qendrore Kombetare e Interpol Tirana dhe Interpol /Roma/ Itali me dt.20.12.2018, pasi Gjykata e Venecias me vendimin penal nr. 11645/13RGNR dt.01.08.2016, ka vendosur masen e sigurise "Arrest me burg", per Vepren Penale "Falsifikim i dokumentave" & "Emigracion ilegal", e parashikuar nga neni 416 te Kodit Penal Italian. Maksimumi i denimit 30 vite.

Sherbimet e policise gjyqësore referojne se paraprakisht, në rrugë policore jane identifikuar si pasuri të investuara nga shtetasi Ilir Lufaj dhe familjarët e tij pikerisht :

- **Një vile banime 4-katëshe luksoze me nje siperfaqe te madhe**, që ndodhet në fshatin Adriatik, Njesia Administrative Mamurras, Bashkia Kurbin.
- **Siperfaqe toke** te regjistruar ne emer te tij dhe familjarve te tij ne zonat e ndryshme te Tales , Lezhes dhe Shengjinit.
- Nje ambient tregtar ku ushtron aktivitet “**Agjensi udhetimesh**” me adres Lagjia Varosh , Lezhe, te regjistruar ne emer te Gjon Lufaj.
- Nje ambient tregtar ku ushtron aktivitet “**Agjensi udhetimesh, money gram**” me adres qender te qytetit te Laçit, te regjistruar ne emer te Gjon Lufaj.
- Nje ambient tregtar ku ushtron aktivitet “**Agjensi udhetimesh**” me adres Lagjia Besleidhja , Lezhe, te regjistruar ne emer te Migena Lufaj.
- Një automjet luksoz me targë **AA 444 IT**, i markës **Ford Mustang**, ngjyra bardhe, te regjistruar ne emer te Ilir Lufaj.

- Një automjet luksoz me targë **AA 151 NI** , i markës **PORCHE 996 CARRERA**, ngjyra bardhe, te regjistruar ne emer te Ilir Lufaj.
- Një automjet luksoz me targë **AA 756 JZ**, i markës **PORCHE CAYENNE S**, ngjyra blu e erret, te regjistruar ne emer te Ilir Lufaj.
- Një automjet me targë **AA 197 FX**, i markës **Mini Cooper S**, ngjyra kuqe, te regjistruar ne emer te Ilir Lufaj.
- Një automjet luksoz me targë **AA 991 VB**, i markës **BMW 740 D**, ngjyra bardhe, te regjistruar ne emer te Gjon Lufaj.
- Një automjet luksoz me targë **AA 151 KX**, i markës **BMW 730 D**, ngjyra gri, te regjistruar ne emer te Gjon Lufaj.
- Një automjet me targë **AA 332 LE**, i markës **DAIMLER CHRYSLER**, ngjyra gri, te regjistruar ne emer te Gjon Lufaj.
- Një automjet me targë **AA 379 EX**, i markës **Opel Korsa**, ngjyra blu, te regjistruar ne emer te Gjon Lufaj.
- Një automjet me targë **AA 929 EU**, i markës **Benz E 280**, ngjyra zeze, te regjistruar ne emer te Gjon Lufaj.
- Një automjet me targë **LA 3924 A**, i markës **Audi 80**, ngjyra blu, te regjistruar ne emer te Gjon Lufaj.
- Një automjet luksoz me targë **AA 151 BN**, i markës **PORCHE CAYENNE** , ngjyra zeze, te regjistruar ne emer te Elvis Lufaj, i vellai.
- Një automjet luksoz me targë **AA 009 CS**, i markës **JEEP VRANGER** , ngjyra blue e erret, te regjistruar ne emer te Elvis Lufaj, i vellai.
- Nje aktivitet bar kafe ne Fushe Mamurras, Kurbin ne emer te Elvis Lufaj, i vellai.

Sherbimet e policise gjyqesore, citojne disa akte te cilat lidhen me veprimtarine kriminale te shtetasit Ilir Pal Lufaj dhe konkretisht :

1. Vendimi Penal nga Gjykata e Venecias, Itali e cila ka lëshuar urdhërin e “Arrestit Ndërkombëtar” për shtetasin Ilir Lufaj, për kryerje të veprave penale “Organizatë kriminale me qëllim emigracionin e paligjshëm dhe falsifikimin e dokumenteve” parashikuar nga Kodi Penal italian, respektivisht vepër kjo e parashikuar nga neni 333 i Kodi Penal shqiptar;
2. Urdhër-arresti me nr.11645/13RGNR-9565RG GIP dt më 01.08.2016 për kryerjen e v. penale:“ » Pjesëmarrje në grup kriminal për organizimin e emigracionit të paligjshëm duke falsifikuar dokumentat e udhëtimit »” të parashikuara nga Kodi Penal Italian per shtetasin Gjon Lufaj, i vellai i Ilir Lufaj.

3. Vendimi Penal 11645/13RGNR dt.01.08.2016, ne baze te te cilit eshte vendosur masa e sigurise "Arrest me burg", per Vepren Penale "Fallsifikim i dokumentave" & "Emigracion ilegal", e parashikuar nga neni 416 te Kodit Penal Italian. Maksimumi i denimit 30 vite per shtetasen Migena Lufaj, kunata e Ilir Lufaj.
4. Ekstradimin me date 04.04.2019 ne Itali te shtetasit Ilir Lufaj.
5. Pasurite qe posedojne familjaret e tij si vila banimi, siperfaqe toke, automjete lukzoze, apartamente apo aktivitete tregtare.
6. Mungesa e një biznesi te tille qe te justifikojte te ardhurat dhe pasurite e ketij shtetasi dhe familjarve te tij, lindin dyshime mbi burimin e tyre.

Sherbimet e policise gjyqesore referojne se sipas informacioneve të marra në rrugë policore, shtetasi Ilir Lufaj dhe familjaret e tij zotërojn shuma të mëdha parash në llogaritë bankare të çelura në Bankat e nivelit të dytë, në emër te tij dhe të familjarëve, shuma këto të cilat mund të jenë me prejardhje nga aktiviteti kriminal i shtetasit **Ilir Pal Lufaj**, si dhe mund të kenë pasuri të paluajtshme, të cilat mund të jene te regjistruara ose ne administrim nga persona te tjere, per te cilat vijon verifikimi.

Ne baze te kerkeses se organit procedues, DRSHTRR Kurbin, me shkresen Nr.2085/1 date 31.05.2019, ka derguar te dhenat, lidhur me automjetet e rregjistruara ne emer te shtetasit Ilir Lufaj dhe familjareve te tij, Elvis Lufaj ( vellai i Ilirit), Gjon Lufaj ( vellai i Ilirit) Migena Lufaj ( kunata e Ilirit/bashkeshortja e Gjonit ) dhe Gjergj Lufaj (vellai i Ilirit) si dhe historikun e automjeteve qe ka patur ne perdorim shtetasit ne fjale.

Nga verifikimi ne sistem elektronik te regjistrimit te mjeteve rezulton se :

1. Ilir Pal Lufaj **disponon** mjetin me targe AA 197 FX te markes **Mini Cooper S**, viti prodhimit 2009, e blere ne vitin 2013, me cmim 6000 euro.
2. Ilir Pal Lufaj **disponon** mjetin me targe AA 444 IT te markes **Ford Mustang**, viti prodhimit 2006, e blere ne vitin 2018, me cmim 5 milion lek.
3. Gjon Pal Lufaj **disponon** mjetin me targe AA 151 KX te markes **BMW 730**, viti prodhimit 2006, e blere ne vitin 2015, me cmim 5000 euro.
4. Gjon Pal Lufaj **disponon** mjetin me targe AA 379 EX te markes **Opel Corsa**, viti prodhimit 1999, e blere ne vitin 2016, me cmim 800 euro.
5. Elvis Pal Lufaj **disponon** mjetin me targe AA 009 CS te markes **JEEP Wranger**, viti prodhimit 1999, e blere ne vitin 2016, me cmim 1 milion lek.

**Ne baze te kerkeses se organit procedues, DPSHTRR, me shkresen Nr. 2233/1 date 14.06.2019 ka konfirmuar se :**

1. Ilir Pal Lufaj ka pasur ne pronesi mjetin me targe AA 151 NI te markes Porche 996 Carrera, te cilen e ka shitur me date **06.03.2019 me cmimin 4 500 euro** shtetasit Gjevalin Marku.
2. Ilir Pal Lufaj ka pasur ne pronesi mjetin me targe AA 628 MF te markes Nissan, te cilen e ka shitur me date **22.01.2018 me cmimin 5000 euro** shoqerise Gjin-Gent Fat.
3. Ilir Pal Lufaj ka pasur ne pronesi mjetin me targe AA 211 LY te markes Mercedes Benz E270CDI, te cilen e ka shitur me date **04.10.2017**, shtetasit Ervis Liko, Dosja e mjetit aktulaisht ndodhet ne DPSHTRR Tirane.
4. Ilir Pal Lufaj ka pasur ne pronesi mjetin me targe AA 756 JZ (AA 696SP) te markes Porche Cayene S, te cilen e ka shitur me date **26.05.2016**, shtetasit Alkrios Pjetra, Dosja e mjetit aktulaisht ndodhet ne DPSHTRR Vlore.
5. Ilir Pal Lufaj ka pasur ne pronesi mjetin me targe AA 424 NF te markes Chrysler Voyager, te cilen e ka shitur me date **23.04.2018**, shtetases Leze Docaj, Dosja e mjetit aktulaisht ndodhet ne DPSHTRR Tirane.
6. Ilir Pal Lufaj ka pasur ne pronesi mjetin me targe AA 179 LI te markes Chevrolet Equinox, te cilen e ka shitur me date **29.09.2016**. shtetasit Omar Nasr, Dosja e mjetit aktulaisht ndodhet ne DPSHTRR Tirane.
7. Gjon Pal Lufaj ka pasur ne pronesi mjetin me targe AA 662 VS (AA 991 VB) te markes BMW 740, te cilen e ka shitur me date **08.01.2019**, shtetasit Loreda Vasku, Dosja e mjetit aktulaisht ndodhet ne DPSHTRR Tirane.
8. Gjon Pal Lufaj ka pasur ne pronesi mjetin me targe AA 938 IO te markes Volvo S60, te cilen e ka shitur me date **02.06.2015** shtetasit Artan Bali, Dosja e mjetit aktulaisht ndodhet ne DPSHTRR Tirane.
9. Gjon Pal Lufaj ka pasur ne pronesi mjetin me targe AA 727 IV te markes Daimler Chrysler, te cilen e ka shitur me date **21.10.2016** shtetasit **Lulzim Bujari**, Dosja e mjetit aktulaisht ndodhet ne DPSHTRR Shkoder.
10. Gjon Pal Lufaj ka pasur ne pronesi mjetin me targe AA 332 LE te markes Daimler Chrysler E280, te cilen e ka shitur me date **06.04.2016** shtetases Kristiana Marku.
11. Gjon Pal Lufaj ka pasur ne pronesi mjetin me targe AA 849 GD te markes Peugeot 607, te cilen e ka shitur me date **11.02.2014** shtetasit Mirism Jella, Dosja e mjetit aktulaisht ndodhet ne DPSHTRR Tirane.
12. Gjon Pal Lufaj ka pasur ne pronesi mjetin me targe AA 929 EU te markes Mercedes E280, te cilen e ka shitur me date **24.01.2017 me cmim 280 000 lek**, shtetasit Saimir Rama.

13. Gjergj Pal Lufaj ka pasur ne pronesi mjetin me targe AA 919 GU te markes Mini Cooper, te cilen e ka shitur me date **24.12.2014**, shtetasit Bilbil Elezaj, Dosja e mjetit aktualisht ndodhet ne DPSHTRR Tirane.
14. Elvis Pal Lufaj ka pasur ne pronesi mjetin me targe AA 151 BN te markes Porche Cayene, te cilen e ka shitur me date **08.09.2017**, shtetasit Olsjon Hoshja, Dosja e mjetit aktualisht ndodhet ne DPSHTRR Tirane.
15. Valbona Ndrec Lufaj ka pasur ne pronesi mjetin me targe AA 993 KV te markes "Renault", te cilen e ka shitur me date **02.09.2015 me cmimin 2000 euro** shtetases Zamira Myftari.

Nga verifikimi i bere me daten 26.6.2019, nga ana e sherbimeve te policise gjyqesore, ne ambientet e jashtme te baneses luksoze 4 kateshe te shtetasit Ilir Lufaj, ne fshatin Adriatik, Mamurras, ndodhen te parkuara mjetet, si :

Mjeti me targe AA 197 FX te markes **Mini Cooper S**, viti prodhimit 2009, e blere ne vitin 2013, me cmim 6000 euro, aktualisht ne pronesi te Ilir Pal Lufaj.

Mjeti me targe AA 444 IT te markes **Ford Mustang**, viti prodhimit 2006, e blere ne vitin 2018, me cmim 5 milion lek, aktualisht ne pronesi te Ilir Pal Lufaj.

Mjeti me targe AA 151 KX te markes **BMW 730**, viti prodhimit 2006, e blere ne vitin 2015, me cmim 5000 euro, aktualisht ne pronesi te Gjon Pal Lufaj.

Mjeti me targe AA 151 NI i markes Porche 996 Carrera, i cili ne dokumente figuron ne emer te shtetasit Gjovalin Marku, i cili e ka blere sipas kontrates se dates 6.3.2019, nga shtetasi Gjergj Lufaj.

Nga verifikimet e bera per keto modele automjesh rezulton se cmimi real i tregut eshte me i larte se cmimi i vendosur ne kontraten e shitje-blerjes.

Vendimet penale te Gjykates Italiane jane te dates **01.08.2016** nderkohe transaksionet me keto automjete jane bere ne periudhen pas ketij vendimi .

Sa më sipër, nisur nga aktiviteti kriminal i vellezerve Ilir Pal Lufaj, Gjergj Lufaj dhe Gjon Pal Lufaj, dhe bashkeshortja e Gjonit, Migena Lufaj, pasurite e tyre dhe te familjareve te tjere, mungesën e një biznesi te tille qe te justifikojte keto te ardhura dhe pasuri, arrihet në përfundimin se automjetet te cilat **aktualisht** jane rregjistruar ne pronesi te shtetasve Ilir Lufaj, Gjon Lufaj dhe Migena Lufaj dhe Gjergj Lufaj, plotesojne kriteret per tu konfiskuar, me qellim qe deri ne perfundim te procesit penal te mos tjetersohen.

Në neni 274/1 i K.Pr.Penale është parashikuar se, kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, me kërkesën e Prokurorit, Gjykata kompetente urdhëron sekuestrimin e tij me vendim të arsyetuar. Sipas nenit 274/2 të K.Penale, sekuestroja mundet që të vendoset edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të K.Penal.

Prokuroria çmon se ekzistojnë kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive, të parashikuar nga neni 274 i K.Pr.Penale, për automjetet të cilat **aktualisht** janë rregjistruar në pronësi të shtetasve Ilir Lufaj, Gjon Lufaj, Migena Lufaj dhe Gjergj Lufaj si dhe mjete të tjera, të shitura prej tyre, por që mendojme se kjo shitje është fiktive, dhe është bërë për të mbuluar gjurmët e veprës penale dhe për të shpëtuar konfiskimit.

Nga sa sipër, cmojmë se duhet kërkuar në Gjykatë, sekuestrimi i mjeteve, një pjesë e të cilave ndodhen në ambientet e banesës vile 4 kateshe me garazh dhe oborr të shtetasit Ilir Lufaj, me të cilin banojnë edhe Migena Lufaj, Gjon Lufaj dhe Elvis Lufaj, që ndodhet në fshatin Fushe-Mamurras, Njësia Administrative Mamurras, dhe në banesën në proces leglizimi të shtetasës Mare Lufaj, e cila është nëna e shtetasve Ilir, Gjon dhe Elvis Lufaj në fshatin Fushe-Mamurras, me qëllim, gjetjen dhe sekuestrimin e mjeteve, që dyshohet se janë produkt i veprimtarisë kriminale ose i përfitimeve nga veprimtaria kriminale.

Për këto arsye, mbështetur në nenet 36 e 287 të Kodit Penal, si dhe nenit 274 të Kodit të Procedurës Penale;

### **K Ë R K O J ;**


**Të caktohet masa e sigurimit personal pasuror: sekuestro preventive mbi automjetet e poshteshenura:**

1. Mjeti me targë AA 197 FX të markes **Mini Cooper S**, viti prodhimit 2009, e blerë në vitin 2013, me cmim 6000 euro, aktualisht në pronësi të Ilir Pal Lufaj.
2. Mjeti me targë AA 444 IT të markes **Ford Mustang**, viti prodhimit 2006, e blerë në vitin 2018, me cmim 5 milion lek, aktualisht në pronësi të Ilir Pal Lufaj.
3. Mjeti me targë AA 151 KX të markes **BMW 730**, viti prodhimit 2006, e blerë në vitin 2015, me cmim 5000 euro, aktualisht në pronësi të Gjon Pal Lufaj.
4. Mjeti me targë AA 379 EX të markes **Opel Corsa**, viti prodhimit 1999, e blerë në vitin 2016, me cmim 800 euro, aktualisht në pronësi të Gjon Pal Lufaj.

5. **Mjeti me targe AA 009 CS te markes JEEP Wranger**, viti prodhimit 1999, e blere ne vitin 2016, me cmim 1 milion lek, aktualisht ne pronesi te Elvis Pal Lufaj.
6. **Mjeti me targe AA 662 VS (AA 991 VB) te markes BMW 740**, te cilen me date 08.01.2019 shtetasi Gjon Pal Lufaj, ja ka shitur shtetasit Loredo Vasko, dhe dosja e mjetit eshte ne DRSHTRR Elbasan.
7. **Mjeti me targe AA 151 NI i markes Porche 996 Carrera**, i cili ne dokumente figuron ne emer te shtetasit Gjovalin Marku, i cili e ka blere sipas kontrates se dates 6.3.2019, nga shtetasi Gjergj Lufaj (mjet i cili, sipas sherbimeve te policise, ndodhet i parkuar tek banesa e shtetasit Ilir Lufaj).

Për ekzekutimin e masës së sekuestros preventive të ngarkohen Policia Gjyqësore prane DVP Lezhe, seksioni i Krimit Ekonomik Financiar si dhe sherbimet e policise te Komisarariatit Kurbin.

**PROKURORI  
BARDHYL SHEHU**



Bashkelidhur ju dergojme nje kopje te urdherit te rregjistrimit te procedimit penal, referimi i vepres penale, kopje te akteve te kerkesve per ekstadimin e shtetasve Ilir Lufaj dhe Migena Lufaj, relacioni i oficerit te policise gjyqesore qe sugjeron sekuestrimin, etj.